

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“SHAHINI EXPORT” SH.P.K**

Sot, më date 10.08.2020, ne të nënshkruarit:

- **Erald Goga** lindur me 05/09/1995 ne Gorican, Berat, shtetas shqiptar, me banim ne Berat, identifikuar me karten e identitetit me Nr.032401957, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

- **Mirjan Goga** lindur me 20/06/1991 ne Gorican, Berat, shtetas shqiptar, me banim ne Berat, identifikuar me pasaporten me Nr.BJ9515161, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kemi vendosur të themelojme një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**SHAHINI EXPORT**” SH.P.K (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

**Neni 1**

Emri i Shoqërisë është: “**SHAHINI EXPORT**” **SH.P.K**

**Neni 2**

(1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën:-Lagja “Goga” ,rruga “Shahinëve”, godina me nr.pasurie 125, Gorican,Ura Vajgurore, Berat.

(2) Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [shahini\\_01@yahoo.it](mailto:shahini_01@yahoo.it)

Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

**Neni 3**

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.

**Objekti i veprimtarise se shoqerise**

**Neni 4**

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

-Import – Eksport, Grumbullim tregtim te fruta perime.

-Megjithate shoqëria ka te drejte qe te shtoje dhe te ndryshoje objektin e veprimtarise se saj me vendim te asamblese se ortakeve.

**Neni 5**  
**Kapitali themeltar**



Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **2 000 000** (Dymilion)) Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues **Erald Goga** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **1 000 000** leke që përbën **50 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues **Mirjan Goga** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **1 000 000** leke që përbën **50 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kontributi i ortakëve do të jetë në para .

#### **Neni 6:**

##### **Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendimin në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### **Neni 7:**

##### **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, përsa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltare janë ligjerisht të transferueshme me rrugë trashgimie.

#### **Neni 8**

##### **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përgjashtimi nga e drejta e votës dhe te tjera modalitete per funksionimin e organit vendimarrës përcaktohen ne statutin e shoqërisë.

## **Neni 9**

### **Administrimi**

Aministrator te shoqërisë emerohen:

1. Z. **Erald Goga** lindur me 05/09/1995 ne Gorican, Berat, shtetas shqiptar, me banim ne Berat, identifikuar me karten e identitetit me Nr.032401957, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit janë te përcaktuara qarte ne statutin e shoqërisë.

## **Neni 10**

### **Viti financiar-ekspertët**

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **Neni 11**

### **Prishja-riorganizimi i shoqërisë**

Modalitetet per prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë te përcaktuara ne statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

## **Neni 12**

Akti i Themelimit është hartuar ne 4 kopje.

## **ORTAKET E SHOQËRISË**

**Erald Goga**

**Mirjan Goga**